



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 112 Datë 15.09.2020

“PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN KORIK 2020, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, i ndryshuar dhe në udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”.Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 30.07.2020 miratoi me 23 vota pro 0 kunder 0 apstenim 6% e muajit Korik.

VENDIM

1. Miratimin e dokumentacionit për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin Korik 2020 **300** familjeve në nevoj me fond **1,244648** te cilat janë aplikuese në sistemin e nd.ekonomike, por nuk janë shpallur fituese. Këto familje janë të përzgjedhura nga njësite administrative sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.
2. I bashkangjitet këtij vendimi lista emerore me shumën përkatëse sipas Njësite Administrative.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori i ndihmës ekonomike dhe sektori i finances.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Kryetar Këshilli
Sokol Sava

